



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 356/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 11.12.2010, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë ankesa si e parregullt.

ARSYETIMI

Më datë 08.12.2010 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AAK, në të cilën pretendohet se anëtarët e subjektit politik PDK me datë 7 Dhjetor 2010 në Bulevardin Bill Clinton kanë vendosur posterin e kandidatit për deputet Bekim Haxhiu mbi posterat e kandidatit nga rradhët e AAK Shkëlzen Jusaj, fakt ky që është në shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 3 (tre) fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterin e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Bekim Haxhiu- Kamishi, nga rradhët e subjektit politik PDK, është vendosur mbi posterat e Shkëlzen Jusaj kandidat për deputet nga rradhët e AAK-së. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Me rëndësi është fakti, se parashtruesi i ankesës nuk e ka vërtetuar përmbajtjen e pretendimeve për arsye se formulari i ankesës se pranuar prej PZAP në datë 08.12.2010 nuk ka qenë i firmosur prej personit të autorizuar të subjektit politik AAK.

Ne kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 3.6, pika (d) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP parashihet si vijon:

118.1 "PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet";

3.6 "Te gjitha ankesat duhet te kenë se paku informacionet vijuese:

..... (d) vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës".

Nga shkresat e lendes PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se formulari i ankesës nuk përmbush kushtet e lartpërmendura, **parashtruesi i ankesës nuk e ka nënshkruar ankesën e paraqitur, për kete arsye dhe duke u bazuar ne në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 356/2010 më datën 11.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Ymer Hoxha

